

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

L I G J

Nr. 10 329, datë 30.9.2010

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9669, DATË 18.12.2006
“PËR MASAT NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 6, pas shkronjës “g” shtohet shkronja “gj” me këtë përmbajtje:

“gj) ngritjen e një qendre kombëtare të shërbimit të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje.”.

Neni 2

Në nenin 8, pas pikës 6 shtohen pikat 7 dhe 8 me këtë përmbajtje:

“7. Punonjësit e shërbimit e të përkujdesjes shoqërore për viktimat e dhunës në familje, pranë institucioneve publike dhe organizatave jofitimprurëse të licencuara, si dhe avokatët e përfaqësuesit ligjorë të viktimave të dhunës në familje ruajnë fshehtësinë e të dhënave personale dhe të informacioneve që viktimat jep për situatën e saj, përveçse kur përcaktohet ndryshe me shkrim nga viktimat.

8. Mekanizmi i bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe mënyra e procedimit të tij për mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 3

Në nenin 9 pika 1, fjalët “postës së policisë” zëvendësohen me fjalët “stacionit të policisë”.

Neni 4

Në nenin 10 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 shkronja “g”, fjala “konfiskojnë” zëvendësohet me fjalën “sekuestrojnë”.

2. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Në rastin e zbatimit të shkronjës “g”, vendimi i gjykatës parashikon:

a) pezullimin e lejes së armës deri në plotësimin e afatit të urdhrit të mbrojtjes, si dhe njoftimin e autoritetit përkatës administrativ, nëse arma është sekuestruar dhe personi ka një autorizim për armëmbajtje me leje;

b) kthimin e armës së sekuestruar, nëse personi ka një autorizim për armëmbajtje me leje, vetëm pas mbarimit të afatit të përcaktuar në urdhrat e mbrojtjes.”.

Neni 5

Në nenin 13 pika 2, pas shkronjës “d” shtohen shkronjat “dh” dhe “e” me këtë përmbajtje:

“dh) policia/prokuroria;

e) personat ligjërisht përgjegjës për fëmijët.”.

Neni 6

Në nenin 14 bëhen këto ndryshime:

1. Në fund të pikës 3 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe Komisioni Shtetëror për Ndhimën Juridike u njoftojnë gjykatave listën e avokatëve, që autorizohen për dhënien e ndihmës juridike falas.”.

2. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Kërkuesi shkarkohet nga të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave për shpenzimet gjyqësore, si dhe ato të shërbimeve përmbartimore shtetërore, sipas dispozitave të legjisllacionit shqiptar në fuqi. Me lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës që ka ushtruar dhunë në familje.”.

Neni 7

Në nenin 18, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Gjykata vendos në lidhje me kërkesën për mbrojtje të menjëhershme:

a) të një të mituri, brenda 24 orëve pas parashtrimit të kërkesës;

b) të subjekteve të tjera të dhunës në marrëdhëniet familjare, brenda 48 orëve pas parashtrimit të kërkesës.”.

Neni 8

Në nenin 19 pika 5, pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:
“d) zyrove përmbarimore të vendit të ekzekutimit.”.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R E
Jozefina Topalli (Çoba)